REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
DREJTORIA PËR ZHVILLIMET NË TERRITOR

Nr. 2178/13 Prot.

Lënda: **Lëshimi i Dokumentit të Lejes së Ndërtimit Nr. 2178/13 Prot, datë 21.10.2026, miratuar me Vendimin Nr. 13, datë 25.06.2025 të KKTU-së.**

Drejtuar: **FONDACIONI "MIRËNJOHJA"**

Sikurse jeni në dijeni, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit në mbledhjen e datës 25.06.2025 ka miratuar Vendimin Nr. 13, Leje Ndërtimi për objektin: **"Godinë banimi dhe shërbimi me 10 kate mbi tokë dhe 1 kat parkimi nëntokë", me vëndndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues Fondacioni "Mirënjohja",** në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Për sa më sipër, bazuar në Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Vendimin Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar dhe Vendimin Nr. 725, datë 02.09.2015 të Këshillit të Ministrave "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit", AZHT në përmbushje të detyrimit si Sekretariat Teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit Ju dërgon bashkëlidhur **Dokumentin e Lejes së Ndërtimit Nr. 2178/13 Prot., datë 21/10/2026,** sipas Vendimit të KKTU-së të sipërcituar.

Gjithashtu Ju informojmë se bazuar në pikën 23, të Urdhrit Nr. 143, datë 03.11.2015 të Kryeministrit "Për ngritjen dhe funksionimin e strukturave përgjegjëse për bashkërendimin e punës me Agjencinë e Zhvillimit të Territorit (AZHT), **subjekti duhet të njoftojë AZHT 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para fillimit të punimeve të ndërtimit.** Njoftimi për fillimin e punimeve, bazuar ne Ligjin Nr. 8402, dt.10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar dhe Udhëzimin Nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar duhet të jetë i shoqëruar me kontratën e sipërmarrjes, e lidhur midis zhvilluesit (apo përfaqësuesit të tyre me prokurë) dhe subjektit ndërtues që do të kryej punimet, dhe me kontratën e sipërmarrjes, e lidhur midis zhvilluesit (apo përfaqësuesit të tyre me prokurë) me mbikëqyrësin e punimeve.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ADELAJDA ROKA
Adelajda Roka
Digitally signed by Adelajda Roka
2026.10.21 21:21:33 +02'00'

Vulosur elektronikisht nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit
Date:2026/10/21 21:21:48 +02'00'
47076ff1d79c4ccaba2449595b1919d520261021212145
55039

Shënim : Ky dokument është firmosur elektronikisht dhe është gjeneruar automatikisht nga sistemi elektronik i menaxhimit të dokumentacionit, ku çdo veprim apo ndryshim i tij është gjurmuar në mënyrë të detajuar. Ai është krijuar si pjesë e një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia e Zhvillimit të Territorit)